



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 426/5 Prot.

Tiranë, më 29.06. 2016

V E N D I M

Nr. 75, datë 29.06.2016

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ,
filluar me Urdhërin e verifikimit nr. 426/1 prot., datë 02.06.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 35, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr. 134 prot., datë 28.06.2016, dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në kryerjen e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, *****.

VËREJ:

Në zbatim të urdhrin nr. 426/1 prot., datë 02.06.2016 "Për verifikimin e informacionit të ardhur nga një nëpunës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me parregullsi të pretenduara gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore", ka filluar hetimi administrativ, dhe mbas këqyrjes së akteve që materializojnë procedurën e ndjekur për zhvillimin e ecurisë disiplinore nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ka rezultuar se:

Kërkuesi ***** , në bazë të rezultateve të konkurrimit të datës 24.12.2013, është emëruar me Vendimin nr. 57, datë 16.01.2014 në pozicionin "Përgjegjës në Sektorin e Pajisjeve Fiskale, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit", pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në përfundim të periudhës së provës, bazuar në vlerësimin e rezultateve individuale në punë si dhe në rezultatin pozitiv të testimit pranë ASPA-s, është bërë konfirmimi i tij "nëpunës civil", në pozicionin e sipërcituar.

Shkaku i mosmarrëveshjes që është objekt i këtij hetimi administrativ është se ndaj këtij nëpunësi është zhvilluar një procedurë disiplinore e cila është iniciuar nga memo nr. 16881 prot, datë 20.05.2016, "Informacion për cekimin e kartës për inspektorin *****", e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Ky i

fundit, menjëherë pas marrjes së informacionit, me aktin nr. 16881/1 datë 20.05.2016, ka urdhëruar fillimin e ecurisë disiplinore, dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në Komisionin Disiplinor, i cili ishte ngritur që më parë me Urdhrin nr. 16063 prot, datë 17.05.2016, *(përbërja e cilit është ndryshuar në të njëjtën ditë, me Urdhrin nr. 16064 prot, datë 17.05.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, duke zëvendësuar Kryetarin e Komisionit të Disiplinës).*

Në datat 25 dhe 27 Maj 2016, janë mbajtur dy seanca dëgjimore të Komisionit të Disiplinës, të materializuara këto me procesverbalet përkatëse, me nr. 83 dhe 83/1. Nga përmbajtja e procesverbalit nr. 83/1, rezulton që Komisioni i Disiplinës, në datën 27.05.2016, ka përmbyllur ecurinë disiplinore, duke vendosur marrjen e masës *“Largim nga shërbimi civil”* për nëpunësin në procedim.

Duke marrë në analizë materialin e shqyrtimit të ecurisë disiplinore dhe konkluzionet e Komisionit të Disiplinës, rezulton se ky i fundit në përmbajtjen e vendimit përfundimtar shprehet:

*“...*****, aktualisht me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Pajisjeve Fiskale”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ka kryer shkelje disiplinore duke u larguar nga puna në mënyrë të pajustificuar dhe duke mos respektuar në mënyrë të përsëritur orarin zyrtar të punës, për rreth dy muaj (braktisur detyrën), mungesë prezence në punë, që sjell pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave për institucionin.*

*Konkretisht, nga verifikimi i lëvizjeve hyrje-dalje si dhe nga rakordimi me kamerat e sigurisë në institucion, për punonjësin *****, konstatohet se për periudhën 04.04.2016 – 19.05.2016 ka vonesa në zbatimin e orarit dhe të kohës së qëndrimit në punë, lëvizje gjatë orarit të punës si dhe mungesa të pajustificuara me miratimin e eprorit direkt apo dokumentacion ligjor....”.*

Nga ana e Komisionit të Disiplinës janë administruar me cilësinë e provave, të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik që verifikon zbatimin e orarit të punës, si dhe foto të marra nga kamerat e sigurisë të vendosura në institucion. Nga ky dokumentacion rezulton se, gjatë periudhës së pretenduar është konstatuar që nëpunësi në fjalë, në disa raste ka hyrë me vonesë në institucion, nga të cilat, disa herë pa kryer cekimin e kartës pranë sistemit elektronik që regjistron hyrje-daljet në institucion, dhe në disa raste të tjera, gjatë kohës së punës ka patur lëvizje, si brenda institucionit ashtu edhe jashtë tij.

Në lidhje me këto konstatime, rezulton që nëpunësi objekt procedimi, më shumë se një herë, ka ngritur pretendimin se të gjitha lëvizjet e tij kanë qenë të justifikuara, pasi kanë qenë lëvizje të detyruara, për të mundësuar realizimin e detyrave të tij funksionale, si dhe të detyrave të ngarkuara me urdhra të veçantë të eprorëve. Këto pretendime janë parashtruar si nëpërmjet observacioneve me shkrim të bëra prej nëpunësit, menjëherë sapo ka filluar ecuria disiplinore, ashtu edhe në seancë dëgjimore, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse në procesverbalin e seancës. Konkretisht, në observacionet e datës dt. 24 dhe 25 maj 2016, protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. 16881/2, dhe 16881/3 prot, ky nëpunës është shprehur:

*“ ... Gjatë gjithë kësaj periudhe (përveç punës së përditëshme) kam qenë i detyruar t'i përgjigjesha edhe takimeve apo komisioneve në Ministrinë e Financave, ku do të cilësoja Komisionin e Certifikimit të Pajisjeve të Reja Fiskale, që kërkonin një kohe të gjatë pune si dhe trajnimet që kam kryer tek Q.T.A.T.D.; Për gjithë këto lëvizje që janë kryer në Ministrinë e Financave, duke qenë se kanë patur të njëjtën shpeshësi dhe të njëjtin qëllim, është vënë në dijeni eprori direkt *****.*

Gjithashtu, nisur nga natyra dhe karakteri i punës, kam kryer lëvizje në lidhje me takimet e shpeshëta me Shoqëritë e Autorizuara, me tatimpaguesit e ndryshëm, si dhe në ndihmesën e dhënë nga ana ime për sektorët e tjerë në DPT e në DRT, lidhur me përdorimin, trajnimin me programet e IT (në veçanti me programin e pajisjeve fiskale). Bashkëlidhur lista e inspektorëve të trajnuar, faqe 2”.

Nga përmbajtja e akteve të administruara, vërtetohet që ky nëpunës, përmes Urdhrit nr. 58, datë 10.05.2016, të Ministrit të Financave, ishte ngarkuar të bëjë pjesë në grupin e punës për evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave teknike në lidhje me funksionimin e pajisjeve të reja fiskale. Ky grup pune përbëhej nga nëpunës të Ministrisë së Financës dhe të DP Tatimeve, të cilët kishin për detyrë të bashkëpunonin edhe me përfaqësues të Shoqërive të Autorizuara, duke vlerësuar edhe propozimet e tyre për zgjidhjen e problemeve. Vërtetohet gjithashtu se, ky nëpunës, edhe më parë, ishte aktivizuar nga Ministria e Financave si pjesëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Miratimin e Pajisjeve Fiskale, që do të shpërndareshin tek përdoruesit (shih shkresën nr. 14661/1, datë 28.10.2015 të Ministri i Financave).

Për veprimtarinë në këto organizma, nëpunësi në fjalë, herë pas here, në mënyrë të përmbledhur, ka informuar eprorin e tij, gjë e cila del nga përmbajtja e materialit të komunikimeve elektronike që ka patur me këtë të fundit, të cilat i janë bërë prezent edhe Komisionit Disiplinor.

Nga përmbajtja e vendimit për dhënien e masës disiplinore, si dhe nga provat e administruara në dosjen e procedimit disiplinor, rezulton se, prej Komisionit Disiplinor nuk është bërë një hetim i plotë dhe vlerësim i drejtë i çështjes, pasi nuk janë marrë në shqyrtim, në asnjë rast, pretendimet dhe provat e sjella nga nëpunësi në procedim, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e ligjshmërisë, profesionalizmit dhe barazisë në një proces administrativ.

Në këtë qëndrim është arritur për faktin se, organi i disiplinës nuk ka marrë shpjegimet e eprorit direkt të nëpunësit ***** , veprim i cili ishte më se i nevojshëm, në kushtet kur të gjitha raportimet për ecurinë e punës nëpunësi i proceduar ka pretenduar se i ka adresuar pikërisht tek ***** (drejtor i komanduar i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit). Për më tepër, kryerja e këtij veprimi administrativ nga ana e Komisionit të Disiplinës është kërkuar dhe nga ana e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm i DPT, ***** , i cili në seancën dëgjimore të zhvilluar, ka pohuar shprehimisht se : “Unë nuk jam eprori direkt, është Eniani dhe ai duhet të ishte këtu”.

Pretendimet e ngritura nga ana e punonjësit të proceduar gjejnë mbështetje edhe në qëndrimin e shprehur nga Ministria e Financave, nëpërmjet shkresës nr. 6571/1 prot., datë 08.06.2016, të Sekretarit të Përgjithshëm të saj, nga përmbajtja e të cilës del qartë se punonjësi ***** , në periudhën Prill – Maj 2016, ka qenë pjesëmarrës në dy grupe të përbashkëta pune (të sipërcituara)

dhe këto projekte kanë kërkuar angazhimin dhe prezencën e tij fizike në mënyrë të vazhdueshme, pranë Ministrisë së Financave.

Në përfundim të procedimit disiplinor, nën ndikimin e mangësive të lejuara, të cilat u përshkruan dhe analizuan më sipër, Komisioni Disiplinor, ka arritur në përfundimin e gabuar, se rasti i punonjësit ***** duhet të trajtohet në bazë të nenit 57, pika 2/ç, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si “Braktisje e punës, ose mungesë e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit” dhe ndaj nëpunësit në procedim ka aplikuar masën “largim nga shërbimi civil”, e cila parashikohet nga pika “ç” e nenit 58, të ligjit në fjalë.

Duke parë rrethanat dhe faktet si janë zhvilluar ngjarjet, provat shpresore të administruara, shkeljen e pretenduar si dhe referimin në dispozitën e sipërcituar, arrihet në përfundimin se Komisioni Disiplinor nuk ka bërë një cilësim të drejtë të rastit dhe për më tepër nuk e ka kuptuar dhe nuk e ka zbatuar si duhet, dispozitën e nenit 57, pika 2/ç, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Nga analiza e përmbajtjes së kësaj dispozite konstatohet se ajo kërkon të plotësohen në mënyrë kumulative, elementet e mëposhtme:

- a. Nëpunësi të ketë braktisur punën ose të ketë munguar në mënyrë të pajustificuar dhe të vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë (*pra mungesa në punë duhet të jetë në mënyrë të pandërprerë, për të paktën 7 ditë pune ose më shumë*).
- b. Kjo braktisje ose mungesë në punë të jetë e shoqëruar me pasoja shumë të rënda, në përmbushjen e detyrave të institucionit.

Në rastin konkret rezulton që në veprimet apo mosveprimet e nëpunësit të proceduar, nuk vërtetohet asnjë nga kushtet që kërkon dispozita në fjalë.

Konkretisht, nuk ka asnjë të dhënë që nëpunësi ***** të ketë munguar pa arsye, në mënyrë të vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë, por përkundrazi nga provat e administruara rezulton se ky punonjës është paraqitur çdo ditë në punë dhe nga institucioni është paguar me pagë të plotë për gjithë periudhën e pretenduar se është thyer disiplina në punë. Mbledhja e minutave të hyrjes apo daljes, pas fillimit apo para mbarimit të orarit zyrtar dhe lëvizjet e ndryshme gjatë orarit të punës, në disa raste, nuk mund të konsiderohen si braktisje pune, apo mungesë në mënyrë të vijueshme për 7 ditë ose më tepër.

Kuptimi i vijueshmërisë, sipas kësaj dispozite, është mosparaqitja në mënyrë të vazhdueshme në punë, për më shumë se 7 ditë pune dhe jo mbledhja e minutave të paraqitjes pas fillimit të ditës së punës apo largimi para mbarimit të saj. Këto janë thyerje të disiplinës në punë, ndaj të cilave mund të merren masa të tjera, më të lehta disiplinore, por nuk mund të klasifikohen si shkelje shumë të rënda disiplinore.

Prej largimeve të herëpashershme të punonjësit që është objekt i procedimit disiplinor, ardhjeve në disa raste me disa minuta vonësë, apo largimeve në disa raste, disa minuta para mbarimit të ditës së punës, jo vetëm që nuk është evidentuar ndonjë pasojë shumë e rëndë në përmbushjen e detyrave funksionale në institucion, por rezulton edhe se, ato kanë qenë lëvizje të justifikuara, të

determinuara nga detyrat shtesë, në grupe bashkëpunimi me institucione të tjera, në të cilat ai ka qenë pjesëmarrës.

Nga hetimi administrativ, nuk rezulton që ky nëpunës të ketë krijuar probleme gjatë gjithë periudhës së punësimit apo që ndaj tij, të jenë marrë masa të mëparshme disiplinore, për të aplikuar masën disiplinore ekstreme, siç është vepruar në rastin konkret. Nga ana e Komisionit të Disiplinës, duhej të ishte bërë, një analizë e pranisë ose jo të elementëve të fajit, në veprimet apo mosveprimet e nëpunësit (*dashje apo pakujdesi e rëndë*), pasi mungesa e këtij elementi bën që të mos jemi para një thyerje të disiplinës në punë.

Duke parë se në zhvillimin e kësaj ecurie disiplinore, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe konkretisht Komisionit Disiplinor të saj, janë shkelur disa norma që rregullojnë marrëdhëniet në shërbimin civil, e konkretisht bëhet fjalë për:

- Shkelje të procedurës në zhvillimin e ecurisë disiplinore, pasi përbërja e KD nuk është bërë sipas përcaktimeve të ligjit sepse në përbërjen e komisionit nuk është përfshirë eprori direkt i nëpunësit në procedim.
- Nuk është kryer një hetim i plotë administrativ pasi nuk janë administruar e nuk janë vlerësuar pretendimet dhe provat materiale të ofruara nga nëpunësi në procedim.
- Është kuptuar dhe zbatuar gabim dispozita e nenit 57, pika 2/ç, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” pasi ajo, siç u analizua më sipër, nuk ka lidhje me rastin konkret.
- Në dhënien e këtij vendimi të Komisioni Disiplinor nuk ka analizuar disa aspekte shumë të rëndësishme si p.sh. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, natyrën dhe rëndësinë e shkeljes, rëndësinë e pasojave të ardhura prej saj, formën e fajit (*dashje apo pakujdesi*) dhe shkallën e fajësisë, përsëritjet e shkeljeve, lidhjen shkakësore midis veprimeve të nëpunësit dhe ardhjes apo mundësisë së ardhjes të ndonjë pasoje të rëndë. etj.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, nenet 16 dhe 35, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, si dhe neneve 108, pika “ç”, 109 pikat “b” dhe “d” të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative*”,

VENDOSA:

1. Të konstatojë të paligjshëm aktin administrativ Vendimin nr. 363, datë 30.05.2016, të Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, referuar nenit 109 pika “d” të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative*” pasi është një akt i cili vjen në kundërshtim me një dispozitë të ligjit material.
2. Për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të drejtojnë procesin e anulimit të tërësisht të aktit administrativ, Vendimit nr. 363, datë 30.05.2016, të Komisionit të Disiplinës së DPT, prej organit që e ka nxjerrë aktin.

3. Të merren masat e duhura administrative që të rregullohen pasojat e ardhura nga ky akt i paligjshëm, duke e kthyer nëpunësin ***** në pozicionin e mëparshëm “Përgjegjës në Sektorin e Pajisjeve Fiskale në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit” pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike si dhe kërkuesi *****.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA